



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

RAPORT MBI KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT NR. 2/2013

5 qershor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, në vijim:

- **Rregullore për sistemet e fluturakeve pa pilot me peshë deri në 20 kg¹**
- **Rregullore për njësitë matëse që përdoren në operime nga ajri dhe toka**

Këto dy projekt-rregullore kanë qenë në procedurë të konsultimit publik nga data 21 janar deri më 6 shkurt 2013, dhe nga data 23 maj -1 qershor 2013². Marrja e komenteve dhe vërejtjeve të palëve të interesit për këto projekt-rregullore është bërë duke aplikuar procedurën e paraparë në nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.1/2012 (konsultimi me shkrim) duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar kushtet për organizimin e takimit me palët e interesit, siç parashihet me nenin 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012.

Thirrja për konsultim publik të palëve të interesit i është dërguar të gjithë hisedarëve në industrinë e aviacionit civil, duke përfshirë ANP “Adem Jashari” dhe aviokompanitë që operojnë në të, institucionet aeronautike të Republikës së Kosovës, dhe më gjerë.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

- **Projekt-rregullorja për sistemet e fluturakeve pa pilot me peshë deri në 20 kg**

Është hartuar me qëllim të të rregullimit të aktiviteteve të ndërlidhura me aviacionin për Fluturaket pa Pilot (FPP) me peshë më të vogël se 20 kilogram, që operojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të zhvillimit dhe lehtësimit të industrisë së FPP-ve duke ofruar kushte të pranueshme për operim të sigurt.

Komente:

1. Neni 4.1 - Kushtet e përgjithshme

Për fluturimet me FPP, do të aplikohen sa vijon:

- Fluturimi duhet të kryhet në atë mënyrë, ashtu që asnjë person tjetër ose pronë të mos rrezikohen dhe rrethina të shqetësohet sa më pak që të jetë e mundur;
- Fluturimi duhet të kryhet brenda 500 metrave nga operatori gjatë gjithë kohës;
- Jashtë hapësirës së kontrolluar, përveç me leje të KTA-së;
- Jashtë zonës me trafik të aeroportit, përveç me leje të KTA-së;

¹ Titulli paraprak ka qenë “Rregullore për fluturaket pa pilot me peshë deri në 25 kg”. Pas konsolidimit të projekt-rregullores dhe hulumtimit të akteve juridike përkatëse të BE-së, është vendosur që pesha e fluturakeve pa pilot të jetë deri në 20 kg.

² Për shkak të ndryshimeve në projekt-rregulloren për sistemet e fluturakeve pa pilot, procedura e konsultimit ka vazhduar nga data 23 maj-1 qershor 2013.

- e) Jashtë çdo baze ajrore ushtarake;
- f) Distanca nga zonat e ndërtuara dhe rrugët e mëdha publike duhet të jetë së paku 150 m;
- g) Niveli i fluturimit nuk duhet të tejkalojë 100 m mbi tokë;
- h) Fluturimi mbi zona me ndërtime të dendura, duke përfshirë zonat me shtëpi vikendi dhe zonat për kamping, si dhe zonat e gjera të hapura ku mbledhen njerëzit, nuk është i lejuar;
- i) Fluturimi mbi zonat e veçanta me ndjeshmëri ambientale nuk është i lejuar.

Paragrafi 4.2 g) të ndryshohet në:

g) Niveli i fluturimit nuk duhet të tejkalojë 100 m (QFE) mbi pikën referente në tokë.

(Dërguar nga Z. Besnik Hajdari, Sekretar i Federatës Aeronautike të Kosovës më datë 24 Maj 2013, në ora 15:23)

1. Përgjigje e AAC-së:

QFE (Station Field Elevation) përcakton presionin atmosferik në lartësinë e aerodromit (ose pragut të pistës), d.m.th. aplikohet vetëm në aerodrome. Projekt Rregullorja përcakton kushtet e operimit në zonat me trafik të aeroportit, në Nenin 4.1 d)

Përveq kësaj kjo projekt Rregullore parasheh operate me FPP në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në vendet dhe hapësirat ajrore për fluturim të modeleve, të miratuara paraprakisht nga AAC-ja, andaj shfrytëzimi i presionit atmosferik në lartësinë e aerodromit ose pragut të pistës (QFE) nuk mund të aplikohet.

- Projekt-rregullorja për njësitë matëse që përdoren në operate nga ajri dhe toka

Është hartuar me qëllim të përcaktimit të specifikave për përdorim të sistemit të standardizuar të njësive matëse që përdoren në operimet nga ajri dhe toka në aviacionin civil të Republikës së Kosovës.

Komente:

Gjatë fazës së konsultimit publik, është kontaktuar Departamenti i Metrologjisë, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në lidhje me fushëveprimin e kësaj projekt-rregulloreje në raport me ligjin në fuqi për metrologji. Pas takimeve me zyrtarë të MTI-së, është vendosur që MTI të nxjerrë një akt nënligjor për zbatimin e Ligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203, me të cilin do të bëhej e mundur futja në përdorim e disa njësive matëse që nuk janë pjesë e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, e të cilat aplikohen në operate nga ajri dhe toka.

Për këtë arsye, është vendosur që deri në nxjerrjen e një akti nënligjor nga MTI, AAC të pezullon procedurën e nxjerrjes së projekt-rregullores për njësitë matëse në operimet nga ajri dhe toka. Pas futjes në fuqi të aktit nënligjor nga MTI, AAC do të vlerësojë nëse ka hapësirë për nxjerrje të rregullores.

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloret nën pikën I të këtij raporti, është pranuar (1) vërejtje/koment. Ndryshimet pasuese në projekt-rregulloren janë shpjeguar nën pikën II më lartë.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i sigurisë së fluturimeve
Zyra për çështje juridike dhe rregullatore